

Datë __/11/2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje karburant, naftë (Diesel) Bashkia Mirditë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV- 09134000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 10 760 286 (Dhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga

ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025, sipas ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohen llojet e taksave dhe detyrimeve vendore si dhe detyrimet e subjekteve për pagimin e tyre, sipas afateve përkatëse.

3. Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në

vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data

e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit. Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

3.1 Subjekti Ofertues duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Mirditë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj).

- Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B **(sipas shtojces 1 të ligjit 52/2020, Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B - Të gjitha instalimet).**

3.2 Vërtetim Teknik të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlersimit të Konformitetit (OMVK) ose nga një shoqëri e akredituar (Per respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nenprodukteve të tyre lëshohen nga organet e miratuara të vlersimit të konformitetit, të akredituara në fushën e certifikimit dhe të inspektimit teknik të linjave teknologjike në fushën hidrokarbure). (Vendimi nr 805/ date 20.12.2021..) Rekomandimi nr 5168 prot date 18.07.2024

3.3 Vërtetim nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) që ndaj ofertuesit nuk rezulton ndonjë masë administrative për shkelje të cilësisë së karburanteve sipas legjislacionit në fuqi.

3.4 Certificate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH

Argumentimi:

Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregëtimin e këtij malli, në zbatim të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999

“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015. VKM-në me nr.538 datë 26.05.2009,vkm, Ligji nr.8450 dt.24.02.1999), si dhe ne perputhje me rekomandimin nr 5168 prot date 18.07.2024

Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.

3.5 Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitjes me pakice, të cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave.

Argumentimi: *Referuar nenit 40, 44 te VKM 285 date 19.05.2021,ky kriter i mundeson AK per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje kontraten me cilësi dhe siguri si dhe është provë e aftësisë profesionale dhe pergjegjësisë së operatorit.*

3.6 Bashkengjitur deklaratës për përmbushjen e specifikimeve teknike duhet të paraqesë flete analizen e pershkruar te specifikimet teknike

3.7 Subjekti ofertues duhet te paraqese **dhe deklaratat si me poshte:**

- Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një faqe të menaxhimit të karburanteve (webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet duke përdorur kartën elektronike.

Kjo faqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor.

Mosofrimi i faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi:*Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“, Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (web page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartës elektronike. Kërkesa per disponimin e nje website te furnitorit eshte e rendesishme pasi furnizimi i karburantit me karte elektronike, transferimi i sasise se karburantit nga furnitor tek AK-ja behet ne menyre elektronike, nepermjet website të furnitorit*

- Subjekti duhet te deklaroje se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë në cdo ditë të javës, me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, deri në përfundim të afateve të efektivitetit të kontratës; **(Deklarate nga subjekti ofertues.)**
- Subjekti duhet te deklaroje se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike. **(Deklarate nga subjekti ofertues.)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane të cilin operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara më lart.

4.Subjekti duhet të deklarojë se furnizimin me naftë në institucione arsimore), do të bëhet me automjet të posaçëm nga ana e operatorit ekonomik sipas kërkesës së autoritetit kontraktor (në të gjitha institucionet arsimore) dhe çmimi i transportit do të përfshihet brenda çmimit të ofertës. Automjeti do të shoqërohet nga personi përfaqësues i Autoritetit Kontraktor në çdo rast furnizimi, përfaqësues ky i cili do të disponojë kartën tip elektronike për kryerjen e veprimeve në stacionin e furnizimit me lëndë djegëse. (Deklarate)

5. Operatori ekonomik duhet të zotërojë (në pronësi apo me qera) 1 (një) mjet autobot për transportin e karburantit sipas kërkesës së AK. Autoboti të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi, Kolaudimi (SGS), police sigurimi, certifikate për transportin e mallrave të rrezikshme dhe pasaporta e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtës. Në rastin kur autoboti është me qera subjekti ofertues duhet **te paraqesë** kontratën noteriale të qerases.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të .Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Referuar nenit 40 të VKM 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, për të vërtetuar se operatori ekonomik disponon kapacitete për të furnizuar me karburant Autoritetin kontraktor sipas kërkesës së tij dhe për ta sjellë mallin pranë AK për furnizimin kerkohet që operatori ekonomik të disponojë mjet autobot i cili vërtetohet me dokumentacionin e pronësise.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 neni 26 i VKM-së, si dhe dokumentet

e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekt i prokurimit: “Blerje karburanti nafte, për Bashkinë Mirditë.

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Europiane të lëndëve djegëse 98/70/EËC, Amendamentit 2003/17/EC, Amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diesel”.

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar	Metoda e Testimit
----	----------	--------	------------------	-------------------

			Min	Max	
1	Numri i Cetanit		51	—	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN 5195 EN 16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	—	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	Kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 dhe 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	—	8	SSH EN ISO 12916
5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	—	10.0	SSH EN ISO 20846 SSH EN ISO 13032 SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e Manganit, nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	—	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55		SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni	% (m/m)	—	0,30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	—	0,01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	—	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	—	24	SSH EN ISO 12662
12	Gryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 ⁰ C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	—	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751
15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë (ësd 1,4) në 60 °C	um(microm)	—	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskozitetit në 40 ⁰ C		2,000	4,500	SSH EN ISO 3104
17	Destilimi %vol e destilati qe vlon deri ne 250°C %vol e destilati qe vlon deri ne 350°C Distilati qe vlon ne 95 % vol.	%(v/v) %(V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924

Duke ju referuar faktit që ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, operatorët ekonomik mund të paraqesin certifikata, për standardet e mësipërme. Pranohet edhe mundësia e paraqitjes së standardit SSH/UNI/DIN/EN,

mbi konformitetin e standardit evropian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga Komisioni i posacëm për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.577 date 21.11.2025, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Blerje karburant (naftë), Bashkia Mirditë”**. me fond limit prej: **10 760 286** (Dhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë pa Tvsh, **lloji i procedures: E hapur-Mallra.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJESIA E PROKURIMIT